

**VENDIM**  
**Nr. 223, datë 9.11.2021**

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 198, DATË 3.9.2018, MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” SHA (FTL SHA), NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 139/3 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018.

- Kushti i pikës 2, i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018, kërkon që: “2. Shoqëria ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ sh.a. (FTL sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri ‘Furnizuesi i Tregut të Lirë’ (FTL sh.a.), nga struktura përkatëse.”.

- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, konkretisht në nenin 9, pika 2, germa “e”, kërkohet: “Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse ...”

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., me shkresën nr. 2852/1 prot., datë 13.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 972/1 prot., datë 18.10.2021, ka bërë me dije ndër të tjera, se, në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a. dhe në funksion të veprimtarisë së shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., është kryer transferimi i strukturës përkatëse nga punëdhënësi OSHEE sh.a. te punëdhënësi “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. Në vijim të këtij procesi shoqëria ka dokumentuar në ERE edhe organigramën e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a.

- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 198, datë 3.9.2018.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Petrit Ahmeti**